

Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës në bazë të nenit 28 dhe nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" Nr. 145/10, 136/11, 41/2014, 41/2014, 53/16 dhe 83/18), si dhe duke vepruar sipas njoftimit për përqendrim i parashtruar nga Srbija Brodbend-Rrjetet kabllore serbe d.o.o. Beograd (Serbia Broadband-Srpske Kablovske mreže do.o.o. Beograd), me seli në adresën Bulevardi Peko Dapçeviq 19, Beograd-Vozhdovac, Republika e Serbisë, i dorëzuar përmes personit të autorizuar Bozhidar Milloshoviq, në seancën e mbajtur më 04.09.2019, merr këtë:

AKTVENDIM

1. Vërtetohet se përqendrimi që i referohet përfitimit të kontrollit të pavarur nga shoqëria tregtare **Srbija Brodbend-Rrjetet kabllore serbe d.o.o. Beograd** (Serbia Broadband-Srpske Kablovske mreže do.o.o. Beograd), me seli në adresën Bulevardi Peko Dapçeviq 19, Beograd-Vozhdovac, Republika e Serbisë, mbi një pjesë të operacionit të shoqërisë **Polaris Media d.o.o. Nish** (Polaris Media d.o.o. Niš), duke ndërmarrë një sërë marrëveshesh përdoruesish për të siguruar shpërndarjen e përmbajtjes së mediave të lidhur nga Polaris Media d.o.o. Nish me shfrytëzuesit e vet, edhe pse është në kuadër të dispozitave të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, nuk do të ketë për pasojë parandalimin, kufizimin ose çrregullimin e konsiderueshëm të konkurrencës efektive të tregut ose pjesës së tij thelbësore, sidomos si rezultat i formimit apo forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve dhe si i tillë **është në përputhje me dispozitat e Ligjit të mbrojtjes së konkurrencës në kuptim të nenit 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.**

2. Parashtruesi i njoftimit për përqendrim obligohet që për njoftimin për përqendrim të paguaj taksë administrative në shumë prej 6.000,00 denarë. dhe për aktvendimin në shumën prej 30.000,00 denarë, sipas numrit tarifar 34 të Ligjit për taksa administrative (Gazeta zyrtare e Republikës së Maqedonisë nr. 17/93, 20/96, 7/98, 13/01, 24/03, 19/04, 61/04 dhe 95/05, 7/06, 70/06, 92/07, 88/08, 130/08, 6/10, 145/10. 17/11) në llogarinë e Buxhetit të Republikës së Maqedonisë së Veriut nr. 100000000063095, llogarinë e pagesës 840.....03161, shifrën e të ardhurave dhe programin 72231300.

3. Padia për ngritjen e kontestit administrativ nuk e prolongon përmbarimin e aktvendimit.

Arsyetim

Në përputhje të nenit 15 të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës, më 30.12.2021, i plotësuar më 25.01.2022, të Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës (në tekstin e mëtejshëm: Komisioni) u dorëzua një njoftim për përqendrim nga shoqëria tregtare Srbija Brodbend-Rrjetet kabllore serbe d.o.o. Beograd (Serbia Broadband-Srpske Kablovske mreže do.o.o. Beograd), me seli në

adresën Bulevardi Peko Dapçeviq 19, Beograd-Vozhdovac, Republika e Serbisë, me të cilin Srbija Brodbend-Rrjetet kabllore serbe d.o.o. Beograd (Serbia Broadband-Srpske Kablovske mreže do.o.o. Beograd ka për qëllim të përfitoj kontroll të pavarur mbi një pjesë të operimit të shoqërisë Polaris Media d.o.o. Nish(Polaris Media d.o.o. Niš), duke ndërmarrë një sërë marrëveshjesh përdoruesish për të siguruar shpërndarjen e përmbajtjes së mediave të lidhur nga Polaris Media d.o.o. Nish me shfrytëzuesit e vet.

Komisioni filloi shqyrtimin e Njoftimit nga dita e pranimit të tij dhe në bazën e të dhënave të paraqitura në Njoftimin për përqendrim , në shtojcat dhe anekset e tyre, konstatoi si në vijim:

Srbija Brodbend-Rrjetet kabllore serbe d.o.o. Beograd është operator i telekomunikimeve në Republikën e Serbisë e cila ofron shërbime të telefonisë fikse, internet dhe shërbime të shpërndarjes së përmbajtjeve të mediave duke shfrytëzuar teknologji të ndryshme në tërë territorin e Republikës së Serbisë.

Srbija Brodbend-Rrjetet kabllore serbe d.o.o. Beograd është në pronësi të plotë të fondeve të këshilluara nga BC Partners LLP. Fondet e BC-së janë kryesisht investitorë financiarë, d.m.th. nuk janë të përfshirë në aktivitetet e përditshme të biznesit të kompanive në të cilat ata investojnë, të cilat menaxhohen nga bordet e tyre të drejtorëve.

BC Partners është e regjistruar në Republikën e Maqedonisë së Veriut përmes shoqërive të varura indirekte si më poshtë:

- Total TV SHPK, me seli të regjistruar në Bulevardin VMRO nr.3, Qendër, Shkup, që merret me shpërndarjen e përmbajtjeve të mediave përmes platformës teknike DTH, dhe
- DIRECT MEDIA SHPKNJP Shkup, me seli të regjistruar në Orce Nikolov 68/3, Qendër, që merret me veprimtari marketingu.

Gjithashtu, në territorin e Maqedonisë së Veriut BC Partners, përmes Junajted Group, janë të pranishëm duke ofruar shërbimet e mëposhtme:

- kanalet televizive të transmetuara nga shoqëritë e lidhura, respektivisht të ritransmetuara nga operatorët vendas, duke përfshirë N1, Grand, Cinemania, sport Klub, Fight Channel, Pikaboo, Vavoom, IDJTV, Lov i Ribolov, Brainz, Nova S, etj.(Junajted Media):
- shërbime reklamimi (Direct Media, Cas Media):
- shërbime telekomunikimesh (TOTAL TV SHPK Shkup: të ardhura minimale në tregun vendor realizojnë SBB dhe Telemah d.o.o. Lubjanë (Telemach d.o.o. Ljubljana).

Pjesë e operimit të Polaris Media d.o.o. Nish që merret përbëhet nga një sërë marrëveshjes përdoruesish që përdoruesit kanë lidhur me Polaris Media d.o.o. për ofrimin e shërbimeve të shpërndarjes së përmbajtjeve mediatike përmes platformës DTH.

Komisioni konstatoi se përqendrimi i parashtruar bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës, sepse i plotëson kushtet e nenit 12 paragrafi (1) pika 2) dhe nenit 14 paragrafi (1) pika 1 dhe pika 2)) të Ligjit për Mbrojtje të Konkurrencës.

Komisioni, duke marrë parasysh kriteret e nenit 17 paragrafi (2), paragrafi (3) dhe paragrafi (4) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës dhe pikën 6 (b) të *Udhëzimeve për përcaktimin e rasteve në të cilat gjatë vlerësimit të përqendrimeve, Komisioni për Mbrojtjen e Konkurrencës zakonisht përcakton se të njëjtat janë në përputhje me Ligjin për mbrojtjen e konkurrencës*, vlerëson se përqendrimi i parashtruar, edhe pse bie nën dispozitat e Ligjit, është në përputhje me të, sepse nuk do ketë në masë të konsiderueshme pengimin, kufizimin ose prishjen e konkurrencës efektive të tregut ose të pjesës qenësore të tij , veçanërisht si rezultat i krijimit ose forcimit të pozitës dominuese të pjesëmarrësve

Duke pasur parasysh këtë vlerësim të përqendrimit, Komisioni vendosi si në dispozitiv të këtij AktVendimi, në përputhje me nenin 19 paragrafi (1) pika 2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës.

Sipas Nenit 53 paragrafi (2) të Ligjit për mbrojtjen e konkurrencës padia nuk e prolongon zbatimin e aktvendimit.

Udhëzim për mjetin juridik

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet padi për inicim të kontestit administrativ në Gjykatën Administrative të Republikës së Maqedonisë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të tij.

KRYETAR
I KOMISIONIT PËR MBROJTJEN E KONKURRENCËS
Prof. Dr. Владимир Наумовски